

Njoftimet e Konferencës



Mësime për Jetën nga Profeti



Presidenti Nelson mbushi 99 vjeç këtë vit! Në bisedën e tij, ai tregoi disa mësimet që i kishte marrë në thuajse 100 vjetët e jetës së tij. Kthehu te faqja 2 për të lexuar atë që ai dha mësim.



“Ungjilli i Jezu Krishtit është një plan që na tregon si të bëhemi çfarë Ati ynë Qielor do që ne të bëhemi.”

Presidenti Dallin H. Oaks, Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

“Jezusi është Krishti. Ai është Shpëtimtari ynë. Shëlbuesi ynë. Ai është miku ynë më i mirë.”

Presidenti M. Rasëll Ballard, President Veprues i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve



“Për shkak të Jezu Krishtit, çdo gjë mund të shkojë mirë.”

Motra Emi A. Rajt, Këshilltare e Parë në Presidencën e Përgjithshme të Filllores

E Dhjeta dhe Ofertat

Në konferencë, ne mësuam disa nga mënyrat se si Kisha i përdor paratë e të dhjetave dhe dhurimeve tona për të bekuar njerëzit anembanë botës!

- Vitin e shkuar, më shumë se **1 miliardë** dollarë amerikanë u përdorën për të bekuar njerëzit nevojtarë.
- **54 milionë** dollarë të tjerë ndihmuan nënat dhe fëmijët në nevojë.
- E dhjeta ndihmon për të përkrahur më shumë se **71 000** misionarë që shërbejnë në **414** misione.
- E dhjeta gjithashtu ndihmon për mirëmbajtjen e **30 000** bashkësive në **195** vende dhe territore.



Duke Parë Konferencën Anekënd Botës



Për shkak të diferencës së orës, ne i shohim në mbrëmje sesionet e paradites së konferencës. Ishim të emocionuar kur Presidenti Nelson lajmëroi tempuj të rinj.

Sofia D., 11 vjeçe,
Rajoni Bratislavë, Sllovaki



Shikimi i konferencës më bëri të doja të isha pranë Jezu Krishtit. Ai është Bariu i Mirë dhe Ai kujdeset për ne, delet e Tij. Nganjëherë ne endemi pak larg, por Ai vjen gjithmonë për të na kërkuar.

Efrain C., 9 vjeç,
Provinca San-Huan, Argjentinë



Ne përgatitemi për konferencën duke shkuar për të blerë ëmbëlsira dhe duke u çlodhur që të mos na zërë gjumi në mes të konferencës. Ne lutemi si familje për kuptueshmëri dhe i lexojmë shkrimet e shenjta. Jam gjithnjë e emocionuar t'ia veshin fjalës së një profeti të gjallë dhe ta dëgjoj fjalën e Perëndisë.

Runakorvashe S., 7 vjeçe,
Rajoni Jugor, Malau

20 Tempuj!

U njoftuan 20 tempuj të rinj në konferencë! Përdor një hartë për të gjetur vendndodhjen e secilit tempull të ri. Ngjyros te hapësira brenda skicës së tempullit kur ta gjesh secilin prej tyre.

